

VENDIM
Nr. 988, datë 8.11.2013

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Integritimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ministria e Integritimit Evropian bashkërendon e monitoron zbatimin e planit të veprimit dhe raporton çdo javë në Këshillin e Ministrave për ecurinë e procesit.
3. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore i raportojnë Ministrisë së Integritimit Evropian, çdo javë, për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga plani i veprimit.
4. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore, për të cilat në planin e veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama